REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 852/20
Datë/Datum. 16.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH .nr. 852/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, ne përbërje të: Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Kompania e Sigurimeve Prisig"sh.a- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Sigal Uniqa Group Austria - lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor për Stafin e NP "TERMOKOS" Sh.a me nr. të prokurimit 20-3991-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) - "TERMOKOS" Sh.a, më datën: 13.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Kompania e Sigurimeve Prisig" sh.a. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor për Stafin e NP "TERMOKOS" Sh.a. me nr. të prokurimit 20-3991-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "TERMOKOS" Sh.a.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor për Stafin e NP "TERMOKOS" Sh.a. me nr. të prokurimit 20-3991-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "TERMOKOS" Sh.a, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Kompania e Sigurimeve Prisig" sh.a- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Kompania e Sigurimeve Prisig" sh.a.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.10.2020 me nr. 852/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Sigurimit Shëndetësor për Stafin e NP "TERMOKOS" Sh.a. me nr. të prokurimit: 20-3991-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "TERMOKOS" Sh.a., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 59, 60 dhe 61 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe Vendimin e OSHP-së nr. 625/20 i datës 06.10.2020.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 27.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 06.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues është njoftuar nga autoriteti kontraktues si tenderues i eliminuar dhe njëherit në sqarimin e dhënë në letrën standarde të OE ankues thuhet se:

- Nuk ka ofruar dëshmi se posedon kartela shëndetsore e cila ka qenë kërkesë e DT-së, dhe
- Sipas formulës së rregullores për cmimie jo normalisht të ulëta, oferta e OE ankues rezulton të jetë ofertë me çmim jo normalisht të ulët.

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyes së parë të eliminimit, sqaron se ky pretendim është trajtuar në raportin e parë të ekspertizës, për të cilën eksperti shqvrtues ka dhënë një përgjigje. Po ashtu, e njoftoj panelin shqyrtues konform rregullores së punës se ky pretendim është trajtuar edhe me vendimin me nr. 625/20.

Prandaj, ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm për faktin se AK-ja përkundër udhëzimeve të dhëna në vendimin e PSH-së, nuk e ka trajtuar këtë pretendim.

Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti te prokurimit, AK-ja konform rregullores për cmime Jo/Normalisht të ulëta ka bërë llogaritjen sipas tabelës së dhënë në këtë rregullore dhe në fund ka rezultuar që pragu të jetë: 55,911.23€.

OE ankues "Pri Sig", me çmimin e dhënë në ofertën e tij (50,922.00) e ka plotësuar kushtin për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht të ulët për faktin se pragu për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht të ulët është 55,911.23€.

Eksperti shqyrtues lidhur me formulën e nxjerr nga autoriteti kontraktues, sqaron se edhe pas llogaritjes e konfirmoj të njëjtën vlerë: 55,911.23€, që do të thotë se pragu për tu konsideruar si oferte me çmim Jo/Normalisht të ulët është vlera e lartshënuar.

Lidhur me këtë çështje OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues nuk i ka zbatuar të gjitha procedurat e parapara Rregulloren për çmime Jo/Normalisht të ulëta, me arsyetimin se autoriteti kontraktues nuk i ka ndjekur procedurat e parapara në nenin 4 të kësaj rregulloreje.

Në Rregulloren për çmime Jo/Normalisht të ulëta, në nenin 4 thuhet:

4.1 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 te LPP dhe paragrafit 3.1 ose 3.2 te këtyre rregullave, një tender i tille **nuk mund të refuzohet** pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.

4.2 Në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit) duket të jetë abnormalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues **duhet të kërkoj me shkrim** nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin që duket të jetë jo-normalisht i ultë, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshin një shpjegim për çmimin e ultë duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja ***"Shkresa standarde për tenderët jo- normalisht të ulët".***

Duke u bazuar ne shkresat e lendes, eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, nuk i ka zbatuar në tërësi procedurat e parapara në nenin 4 të rregullores së lartpërmendur për faktin se pavarësisht se OE ankues e ka plotësuar kushtin për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht te ulet, përjashtimi automatik është i ndaluar në nenin 4.1 të kësaj rregulloreje.

Pra, nuk mund të eliminohet pa hetimin dhe shqyrtimin e çmimit te dhënë nga një operator ekonomik, qe do te thotë se AK-ja është e obliguar që të veproj sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 4 të Rregullores për çmime Jo/Normalisht të ulëta. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarim me shkrim lidhur me çmimin e dhënë nga OE ankues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues me datë 06.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 09.11.2020 me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 13.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Kompania e Sigurimeve Prisig" sh.a- Prishtinë, se është eliminuar nga eliminuar nga AK me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmi se posedon kartela shëndetësore e cila ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe sipas formulës së rregullores për çmime jo normalisht të ulëta, oferta e OE ankues rezulton të jetë ofertë me çmim jo normalisht të ulët.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sa i përket arsyes së parë të eliminimit, sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe me vendimin me nr. 625/20. Prandaj, ky pretendim është pjesërisht i qëndrueshëm për faktin se AK-ja përkundër udhëzimeve të dhëna në vendimin e PSH-së, nuk e ka trajtuar këtë pretendim.
Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti te prokurimit, AK-ja konform rregullores për çmime Jo/Normalisht të ulëta ka bërë llogaritjen sipas tabelës së dhënë në këtë rregullore dhe në fund ka rezultuar që pragu të jetë: 55,911.23€. OE ankues "Pri Sig", me çmimin e dhënë në ofertën e tij (50,922.00) e ka plotësuar kushtin për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht të ulët për faktin se pragu për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht të ulët është 55,911.23€. Lidhur me këtë çështje OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues nuk i ka zbatuar të gjitha procedurat e parapara Rregulloren për çmime Jo/Normalisht të ulëta, me arsyetimin se autoriteti kontraktues nuk i ka ndjekur procedurat e parapara në nenin 4 të kësaj rregulloreje. Andaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk i ka zbatuar në tërësi procedurat e parapara në nenin 4 të rregullores së lartpërmendur për faktin se pavarësisht se OE ankues e ka plotësuar

kushtin për tu konsideruar ofertë me çmim Jo/Normalisht te ulet, përjashtimi automatik është i ndaluar në nenin 4.1 të kësaj rregulloreje.

Pra, nuk mund të eliminohet pa hetimin dhe shqyrtimin e çmimit të dhënë nga një operator ekonomik, që do të thotë se AK-ja është e obliguar që të veproj sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 4 të Rregullores për çmime Jo/Normalisht të ulëta. Prandaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se ky pretendim i OE ankues është i qëndrueshëm për faktin se autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar sqarim me shkrim lidhur me çmimin e dhënë nga OE ankues.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka eliminuar operatorin ekonomik në kundërshtim me rregullat për tenderët jo normalisht të ulët. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se AK nuk ka marrë parasysh udhëzimet e dhëna në vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr.625/20. Andaj, obligohet autoritet kontraktues të zbatoj rregullat për tenderët jo normalisht të ulët dhe të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues i tërheq vërejtën autoritetit kontraktues që të merr parasysh dhe zbatoj në tërësi vendimet e Panelit Shqyrtues, në të kundërtën e detyron Panelin Shqyrtues që të merr masa ndaj AK-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "TERMOKOS" Sh.a;

1x1 OE "Kompania e Sigurimeve Prisig"-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.